



Raport për rezultatet e konsultimit publik

1. Titulli i draft aktit

Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike””.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë projektakt ishte 20 ditë pune (14.05.2024-11.06.2024).

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e përdorura për këtë projektakt:

1. Regjistri Elektronik (RENJK)
2. Posta elektronike
3. Shkresë zyrtare
4. Takime online me institucionet

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e përfshira në këtë proces ishin institucionet të cilat kanë dhënë komentet/ sugjerimet e tyre dhe shoqëria civile.

Lidhur me këtë projektligj më datë 19.06.2024, ora 10:00 është zhvilluar një takim online në kuadër të procesit të bashkërendimit, në të cilin morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Kryeministria, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe Departamenti i Administratës Publike.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Rregullimi i marrëdhënies së punës të drejtorit të përgjithshëm, dhe nëpunësve të AKSHIT me ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”	Ligji Nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, duhet ndryshuar në mënyrë të atillë që, marrëdhëniet e nëpunësve të administratës së AKSHI-t të rregullohen me ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe jo nga Kodi I Punës. Në këtë kuadër, drejtori i përgjithshëm i AKSHIT-t duhet të fitojë <i>ex officio</i> dhe gëzojë, jo vetëm statusin e nëpunësit civil, por dhe atë të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues.	Shoqëria civile	Ky sugjerim është refuzuar	Lidhur me këtë koment AKSHI sqaron se: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është institucion i administratës shtetërore, me statusin e personit juridik publik buxhetor, në varësi të Kryeministrit. Struktura dhe organika e AKSHI-t miratohen me urdhër të Kryeministrit dhe rekrutimi dhe marrëdhëniet e punës të drejtorit të përgjithshëm dhe nëpunësve të këtij institucioni rregullohen në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu sqarojmë se që prej vitit 2007 me krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, marrëdhëniet e punës janë rregulluar në bazë të Kodit të Punës si pasojë e rëndësisë së këtij institucioni si dhe për shkak të evoluimit të shpejtë dhe të shpeshtë të teknologjisë. Rregullimi i marrëdhënies së punës me Kod Pune ofron më shumë

				fleksibilitet dhe më pak burokraci duke mundësuar kështu një mjedis pune gjithmonë në zhvillim si dhe duke ju përshtatur nevojave të teknologjisë. Gjithashtu, rregullimi i marrëdhënies së punës me ligjin nr. 152/2013 “<i>Për nëpunësin civil</i>” mund të ngadalësojë avancimin në karrierë si dhe mund ta bëjë këtë proces më të varur nga kriteret burokratike se sa nga performanca individuale.
Shtimin e një dispozite kalimtare lidhur me strukturat TIK në institucione.	Ligji duhet të përmbajë një dispozitë kalimtare duke parashikuar i. të paktën një nëpunës IT pranë cdo institucioni të administratës shtetërore ii. transferimi i tyre pranë AKSHI-t, si dhe përcaktimi i procedurave të transferimit dhe afati për to.	Shoqëria civile	Ky sugjerim është pjesërisht i pranuar	Lidhur me këtë sugjerim AKSHI sqaron se ky sugjerim është pjesërisht i pranuar pasi: Këto sugjerime janë të rregulluar që prej vitit 2017, nëpërmjet vendimit Nr.673/2017 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar. Në këto kushte vlerësojmë se këto sugjerime të mos përfshihen në projektakt pasi përcaktimi i tyre në vendim të Këshillit të Ministrave të ofron më shumë fleksibilitet për përmirësimin e çështjes në të ardhmen nëse do të jetë e nevojshme, brenda përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.